



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 25 Mars 2021

Nr: 11

**VENDIM
PËR
MËNYRËN E NGRITJES, ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË
QENDRËS SË VOTIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE NË QENDRËN E
VOTIMIT**

*(ndryshuar me vendimin nr. 15 date 12.4.2021
ndryshuar me vendimin nr. 6 date 27.1.2022
ndryshuar me vendimin nr. 12 date 24.3.2023)*

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 25.03.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit.

BAZA LIGJORE: Neni 20, paragrafët 1, shkronja “a” dhe “b”, dhe 3, neni 22, paragrafi 3, neni 36 e vijues të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafët 1, shkronja “a” dhe “b”, nenin 36 e vijues të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



VENDOSI

PJESA I TË PËRGGJITHSHME

KREU I OBJEKTI, PËRKUFIZIME DHE PARIME

Neni 1 **Qëllimi dhe objekti**

1. Qëllimi i këtij vendimi është organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Qendrës së Votimit (më poshtë “KQV”), në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Objekti i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat për ngritjen, organizimin, funksionimin e KQV-së, marrjen e vendimeve, dhe përcaktimin e procedurave për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore të miratuara nga KQZ-ja.

Neni 2 **Përkufizime**

3. “KQV” është Komisioni i Qendrës së Votimit.
4. “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
5. “KZAZ” është Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që ngrihet dhe funksionon në përputhje me Kodin Zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore.
6. “Marrëdhënie krushqie e afërt” është lidhja e krushqisë midis anëtarit të komisionit dhe kandidatit, ku njëri prej tyre është prind i bashkëshortit ose bashkëshortes së tjetrit apo motër ose vëlla i bashkëshortit ose bashkëshortes, apo bashkëshort i motrës së bashkëshortes ose të bashkëshortit apo bashkëshorte e vëllait të bashkëshortes ose të bashkëshortit.
7. “Identifikimi elektronik” është identifikimi i zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me pajisje dhe përjasja e tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, si dhe regjistrimi në pajisje i shenjave daktiloskopike.
8. “PEI” është pajisja që kryen identifikimin elektronik të zgjedhësit, nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale dhe regjistrimit të shenjave daktiloskopike.
9. “QV” është qendra e votimit, mjedisi i caktuar për zhvillimin e votimi, në përputhje me Kodin

Zgjedhor.

Neni 3

Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e KQV-së

1. Veprimtaria e KQV-së mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja.
2. KQV-ja ngrihet dhe funksionon për të gjitha llojet e zgjedhjeve.
3. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve.
4. KQV përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ.
5. Veprimtaria e KQV-së bazohet në parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, profesionalizmit, pavarësisë, paanësisë, objektivitetit, përgjegjësisë dhe transparencës.

KREU II

PËRBËRJA DHE EMËRIMI I ANËTARËVE TË KQV-së

Neni 4

Përbërja e KQV-së

1. KQV-ja përbëhet nga shtatë anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit.
2. KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kriterëve të nenit 29 të Kodit Zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje.
3. Renditja e partive politike për efekt të ndarjes së vendeve në KQV, është e njëjtë me renditjen e partive politike që propozojnë anëtarët e KZAZ-së, të përcaktuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
4. Anëtarët e KQV-së emërohen nga KZAZ-ja, sipas kësaj procedure:
 - a) partitë politike sipas parashikimeve të paragrafit 3 të këtij neni, paraqesin në KZAZ, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve. Në rastin e zgjedhjeve të pjesshme apo të parakohshme, propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve paraqiten 20 ditë para datës së zgjedhjeve;
 - b) kryetari dhe sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja;
 - c) në KQV-të ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KQV-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër zgjidhet njëri nga anëtarët e KQV-së, përfaqësues i

partisë kryesore të opozitës parlamentare. Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin, sipas rastit përfaqësues i partisë kryesore të shumicës ose opozitës parlamentare.

Neni 5

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së

Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jenë:

- a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- b) kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose
- ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Neni 6

Kushtet për emërimin e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së

1. Anëtar ose sekretar i KQV-së mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
 - b) ka të paktën arsimin e mesëm;
 - c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
 - ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; dhe
 - d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.
2. Sekretari i KQV-së, si rregull, ka arsimin e lartë.

Neni 7

Caktimi i partisë politike që propozon anëtarin e shtatë të KQV-së

1. KZAZ-ja, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, cakton partinë politike që do të propozojë anëtarin e shtatë të KQV-ve, sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) të gjithë QV nën juridiksion territorial të Zonës së Administrimit Zgjedhor renditen sipas numrit të tyre unik në rend rritës, duke nisur nga QV me numër më të vogël. QV, numri unik i të cilave është me fraksion, renditen pas QV-ve të origjinës.
 - b) QV-të e renditura sipas pikës “a” të këtij neni, numërtohen me numra natyrorë, duke filluar nga numri 1 (një) e duke vazhduar në rend rritës deri në numërtimin e QV-së së fundit.

- c) në QV që mbajnë numër çift në renditjen sipas shkronjës “b” të këtij neni, anëtari i shtatë i KQV-së do të propozohet nga partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së;
 - ç) në QV-të që mbajnë numër tek në renditjen sipas shkronjës “b” të këtij neni, anëtari i shtatë i KQV-së do të propozohet nga partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së;
2. KZAZ-ja, pas kryerjes së kësaj procedure, menjëherë, njofton partitë politike përkatëse për paraqitjen e propozimeve për anëtarin e shtatë të KQV-ve.

Neni 8

Paraqitja e propozimeve për anëtarë dhe sekretarë të KQV-së

1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve, depozitojnë në KZAZ listën me propozimet dhe dokumentacionin përkatës për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve në rang ZAZ, jo më vonë se 30 ditë nga data e zgjedhjeve.
2. Partitë politike mund të autorizojnë degët lokale për të paraqitur kandidaturat për anëtarë të KQV-ve. Autorizimi paraqitet si më poshtë:
 - a) i nënshkruar nga Kryetari i Partisë Politike dhe i vulosur me vulën e partisë;
 - b) përcakton numrin e KZAZ-së/KZAZ-ve, ku dega lokale e partisë politike do të paraqesë kandidaturat për anëtarë të KQV-ve;
 - c) depozitohet në KZAZ së bashku me listën dhe dokumentacionin e kandidatura për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve.
3. Lista me emrin dhe logon e partisë politike, përmban kandidaturat e renditura sipas KQV-ve, nënshkruhet nga kryetari ose përfaqësuesi i autorizuar i partisë politike, dhe vulozet me vulën përkatëse. Për çdo kandidaturë, pasqyrohet emri, atësia, mbiemri, datëlindja, numri personal i identifikimit, gjinia, arsimi, numri telefonik i kontaktit dhe adresa e postës elektronike. Lista paraqitet në letër dhe formë elektronike, format excel, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Për çdo kandidaturë të propozuar, bashkëlidhur listës paraqitet dokumentacioni:
 - a) çertifikatë personale lëshuar nga zyra e gjendjes civile, ose nga portali e-albania;
 - b) deklaratë e nënshkruar e kandidatit, sipas lidhjes 2, përmes së cilës deklaron se:
 - i. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - ii. nuk ka marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - iii. nuk ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;
 - iv. nuk është në marrëdhënie pune me ndonjë nga kandidatët që konkurojnë në zonë;
 - v. ka arsimin e mesëm/të lartë;

- vi. nuk është deputet ose kandidat për deputet në Kuvend;
 - vii. nuk është kandidat ose i zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
 - viii. nuk është ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
 - ix. nuk është anëtar apo sekretar i një komisioni tjetër zgjedhor.
5. Sekretari i KQV-së, si rregull, ka arsimin e lartë.

Neni 9

Emërimi i kryetarit, sekretarit dhe anëtarëve të KQV-së

1. KZAZ-ja, brenda 3 (tre) ditëve nga paraqitja e propozimeve, për çdo kandidaturë për anëtar dhe sekretar të KQV kryen verifikimin e plotësimit të kërkesave të neneve 5 dhe 6 të këtij Vendimi.
2. Partia politike, jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i KZAZ-së për mangësi të propozimeve apo dokumentacionit të paraqitur, plotëson mangësitë ose ridepoziton propozim për zëvendësim të kandidaturës.
3. KZAZ-ja, emëron anëtarët, kryetarët dhe sekretarët e KQV-ve, jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 5 dhe 6 të këtij Vendimi.
4. Në çdo rast emërimi i anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-ve bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve.
5. KZAZ-ja dërgon menjëherë në rrugë elektronike në KQZ, një kopje të vendimeve për emërimin e anëtarëve, kryetarit dhe sekretarit të KQV-së si dhe listën në format elektronik sipas paragrafit 3 të nenit 8 të këtij Vendimi.
6. Anëtarët e KQV-së përfitojnë shpërblimin për punën e bërë. Masa e shpërblimit caktohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Neni 10

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur:
 - a) shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe të akteve nënligjore të KQZ-së, lidhur me detyrat e KQV-së;
 - b) dënohen me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - c) nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht;
 - ç) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

2. Anëtari dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur :
 - a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;
 - b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë;
 - c) japin dorëheqjen nga detyra;
 - ç) nuk plotësojnë më kushtet për të qënë zgjedhës.
 - d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre
3. Anëtari dhe sekretari i KQV-së, i shkarkuar me vendim të KZAZ-së, nuk mund të rizgjidhet në këtë detyrë.
4. KZAZ-ja, dërgon menjëherë në KQZ kopje të vendimeve për shkarkimin apo për lirimin nga detyra të anëtarëve apo sekretarit të KQV-së.

Neni 11 **Dorëzimi i detyrës**

1. Anëtari apo sekretari i KQV-së i liruar apo dorëhequr nga detyra, nuk mund të largohet nga KQV-ja, pa dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi i tij.
2. Kur anëtari apo sekretari i KQV-së jep dorëheqjen, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KQV ose sipas rastit në KZAZ.
3. Kur deklarata e dorëheqjes depozitohet në KQV, sekretari i KQV-së:
 - a) administron deklaratën e dorëheqjes;
 - b) bën shënimet përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;
 - c) njofton menjëherë KZAZ-në.
4. Në rastin kur Sekretari i KQV-së është shkarkuar, liruar, apo ka dhënë dorëheqjen nga detyra, procedurat sipas parashikimeve të paragrafit 3 të këtij neni, kryhen nga një anëtar i KQV-së me të njëjtën përkatësi politike. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së bëhet shënimi përkatës për pasqyrimin e këtij fakti.

Neni 12 **Plotësimi i vakancës në KQV**

1. KZAZ, për plotësim të vakancës në KQV, emëron anëtarin apo sekretarin e ri të KQV-së:
 - a) brenda 3 ditëve nga konstatimi i vakancës, por jo më vonë se 24 orë para hapjes së procesit të votimit;

- b) Në ditën e zgjedhjeve, jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i mungesës,.
2. Kryetari, sekretari ose çdo anëtar i KQV-së njoftojnë menjëherë KZAZ-në për mungesa të anëtarit/ëve të KQV-së:
- a) një orë para hapjes së votimit;
 - b) largimin gjatë ditës së votimit.
4. KZAZ-ja njofton menjëherë degën lokale të partisë përkatëse për:
- a) krijimin e vakancës në KQV-në përkatëse, duke i bashkëngjitur njoftimit, sipas rastit, kopje të deklaratës të dorëheqjes të anëtarit të KQV-së, depozituar në KZAZ;
 - b) afatin për dorëzimin e propozimit dhe dokumentacionit për vendin vakant të anëtarit apo sekretarit të KQV-së:
 - i. brenda tre ditëve nga konstatimi i vakancës, por jo më vonë se 24 orë nga hapja e procesit të votimit;
 - ii. Në ditën e zgjedhjeve brenda një ore nga marrja e njoftimit.
3. Zëvendësimi i anëtarëve të KQV-së bëhet si rregull me persona të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor.
4. KZAZ-ja me marrjen e propozimit, shqyrton dokumentacionin dhe emëron anëtarin e propozuar brenda afateve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 13

Plotësimi kryesisht i vakancës në KQV

1. Kur KQV-ja ka mbetur pa kuorum 24 orë para hapjes së procesit të votimit, ose në ditën e zgjedhjeve, dhe nuk është kryer zëvendësimi sipas parashikimeve të nenit 12, paragrafi 1, të këtij Vendimi:
- a) KZAZ-ja:
- i. urdhëron menjëherë KQV përkatëse të vazhdojë procedurat dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës;
 - ii. emëron kryesisht anëtarët e KQV-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje, me emra nga lista e miratuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në rastet kur numri i shtetasve në listë është më i madh se numri i KQV-ve që kanë vakancë zbaton procedurat e parashikuara në nenin 12 të Udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësim të vakancës në KZAZ dhe KQV”.

b) KQV-ja:

- i. procedon me zbatimin e detyrave pas urdhërimit nga KZAZ-ja, pavarësisht nga kuorumi;
- ii. shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, emrat e anëtarëve që nuk u paraqitën në detyrë apo u larguan gjatë ditës së zgjedhjeve, dhe orën e komunikimit të urdhërimit nga KZAZ për vazhdimin e procedurave pavarësisht kuorunit.

KREU III
FUNKSIONIMI I KQV-SË

Neni 14
Detyrat e KQV-së

1. KQV-të kanë për detyrë:

- a) zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së;
- b) zbatimin e rregullave të përcaktuara nga KQZ për mënyrën e vënies në funksion të pajisjes së teknologjisë së informacionit dhe sistemit të video-rregjistrimit,
- c) kryerjen në fshehtësi të votimit dhe mos cënimin e fshehtësisë së votimit.

Neni 15
Detyrat e anëtarit të KQV-së

1. Anëtari i KQV-së gjatë ushtrimit të detyrës ka për detyrë:

- a) të zbatojë me përpikmëri Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ-së, vendimet e KZAZ-së, dhe vendimet e KQV-së;
- b) të paraqitet në detyrë dhe të marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga KQZ në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor;
- c) të veprojë në mënyrë të paanshme për zbatimin e detyrave, vendimeve të KQZ, KZAZ-së dhe KQV-së;
- ç) të mos lejojë që interesat private të bien ndesh me detyrën, të shmangë konfliktin e interesit dhe të mos shfrytëzojë detyrën për interesin privat;
- d) të zbatojë dhe të respektojë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim dhe sjellje;
- e) të jetë i ndershëm në kryerjen e detyrave, i përkushtuar dhe korrekt, duke patur parasysh vetëm interesin publik.

Neni 16
Detyrat e sekretarit të KQV-së

Sekretari i KQV-së kryen këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së;
- b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KQV-së;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
- ç) përgatit në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KQV-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;
- d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KQV-së;
- dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KQV-ja dhe i vulos ato;
- e) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;
- ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vertetuara të vendimeve të KQV-së dhe të procesverbaleve të mbledhjeve;
- f) përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në Kutinë e Materialeve të Votimit dhe vulosjen e saj me vulat me kodet e sigurisë;
- g) u jep anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare kopje të Procesverbalit të Vulosjes së Kutisë së Votimit me vulën e KQV-së;
- gj) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së:
 - i. marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja, sipas nenit 100 të Kodit Zgjedhor dhe të dokumentuar në procesverbalet përkatës, dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor;
 - ii. vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin KQV-së.

Neni 17
Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.
2. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së.
3. Vendimet e marra nga KQV-ja që kryen detyrat nën kuorum, sipas nenit 13 të këtij Vendimi, quhen të vlefshme.

4. Vendimet e KQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij, deklaron në vendim votën “pro” ose “kundër”, si dhe arsyetimin përkatës.
5. KQV-ja merr vendim për:
 - a) hapjen e votimit;
 - b) pezullimin e votimit;
 - c) kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit;
 - ç) largimin e forcave të policisë pas rivendosjes së rendit në qendrën e votimit;
 - d) largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit, sipas nenit 110 të Kodit Zgjedhor;
 - dh) përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit në rast kundërshtimi, sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor;
 - e) mbylljen e votimit;
 - ë) vijimin e votimit pa identifikimin elektronik të zgjedhësve në rastet e parashikuara në nenin 44 të këtij Vendimi.
6. Në rast se KQV-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet menjëherë për shqyrtim KZAZ-së nga kryetari ose nga të paktën dy anëtarë të KQV-së, apo mund të ankimohet në KZAZ nga subjekti i interesuar. Vendimi i KZAZ-së zbatohet nga KQV-ja.

KREU IV

DORËZIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 18

Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ

1. Kryetari dhe sekretari i KQV-së, të shoqëruar nga çdo anëtar tjetër që kërkon, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, paraqiten në selinë e KZAZ-së dhe tërheqin:
 - a) kutinë me materialet zgjedhore, e cila përmban:
 - i. fletët e votimit, në përputhje me numrin e zgjedhësve të rregjistruar në QV, plus fletët shtesë;
 - ii. vulën e KQV-së;
 - iii. procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë edhe formularët tip të procesverbaleve dhe të vendimeve për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, kërkimin e ndihmës së policisë dhe të largimit të saj, si dhe mbylljen e votimit;

- iv. Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;
- v. zarfin në të cilin është shënuar “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”;
- vi. zarfin në të cilin është shënuar “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA”;
- vii. zarfin në të cilin është shënuar “ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”;
- viii. zarfin në të cilin është shënuar “ZARFI I VËRTETIMEVE TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”;
- ix. lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësit

b) Përveç kutisë me materiale zgjedhore, sipas shkronjës “a” të paragrafit 1 të këtij neni, KQV merr në dorëzim:

- i. kutinë/kutitë e votimit;
- ii. listën e zgjedhësve;
- iii. dhomat e fshehta;
- iv. vulat me kodet e sigurisë;
- v. mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

2. Kryetari i KQV-së merr në dorëzim vulën e kryetarit nga KZAZ-ja. Kryetari i KQV-së, në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, kryen sipas radhës veprimet e mëposhtme:

- a) merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara;
- b) gris ambalazhin e vulës;
- c) në një letër të bardhë vulos modelin e krahasimit të vulës; dhe
- ç) poshtë modelit të krahasimit të vulës të vulosur në letrën e bardhë shënon me shkrim dore emrin dhe mbiemrin e tij dhe nënshkruan në prani të anëtarëve të KZAZ-së.

3. Letra e bardhë me modelin krahasues të vulës të Kryetarit të KQV-së, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nënshkruhet në pjesën e pasme të saj nga anëtarët e KZAZ-së dhe mbahet në ruajtje nga sekretari i KZAZ-së.

4. Vulat me kodet e sigurisë dorëzohen me procesverbal të veçantë, në të cilin shënohen kodet e sigurisë për çdo vulë. KQV-ja merr në dorëzim aq vula me kode sigurie sa duhen për mbylljen e kutive të votimit dhe për mbylljen e kutisë me materiale zgjedhore, si dhe tri vula shtesë për përdorim vetëm në rast dëmtimi. Vulat shtesë kanë ngjyrë të ndryshme nga ato që do të përdoren si rregull për mbylljen e kutisë së votimit. Një kopje e procesverbalit, ku janë shënuar kodet e sigurisë, duke përfshirë edhe kodet shtesë të sigurisë, mbahet nga KZAZ-ja dhe një kopje i jepet KQV-së.

5. Procedurat për dorëzimin, testimin dhe kthimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), përcaktohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

6. Procedurat për dorëzimin e kamerës për video regjistrim në mjedisin e brendshëm të qendrës së votimit përcaktohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Neni 19

Kamera në QV

1. Për të provuar rregullshmërinë e procesit të votimit, në mjediset e brendshme të çdo QV-je vendoset një kamera për video regjistrim, me specifikime teknike sipas lidhjes 3 bashkëlidhur këtij Vendimi. Përdorimi i kamerës në QV kryhet sipas rregullave të përcaktuara në lidhjen 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Personi i ngarkuar me detyrë nga KQZ për funksionimin e kamerës, vendos mbajtësen dhe kamerën duke iu referuar planvendosjes orientuese sipas skemës tip bashkëlidhur Udhëzimit nr.1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së endrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhje”. Procesi i regjistrimit video fillon me paraqitjen e anërëve të KQV në qendrën e votimit dhe vijon në mënyrë të pandërprerë deri kur KQV me kutinë/të e votimit, kutinë e materialeve të votimit, dhe operatori teknik me pajisjen PEI largohen nga QV për dorëzimin e tyre në VNV.
3. Personi i ngarkuar me detyrë nga KQZ për mbikqyrjen e funksionimit të kamerës, në momentin e ndezjes së saj dhe gjatë ditës së votimit, njofton menjëherë asistencën teknike për probleme të mosfunksionimit.
4. Kryetari, sekretari, dhe çdo anëtar tjetër i KQV-së, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk kanë të drejtë ndezin, fikin apo shkëpusin lidhjen e kamerës me rrjetin elektrik dhe/ose të ndryshojnë pozicionin e saj.
5. Materiali video i regjistruar nga kamerat në mjediset e brendshme të QV-ve ruhet në KQZ deri në përfundim të verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike. Pas përfundimit të kësaj periudhe, materiali ruhet në përputhje me ligjin “Për arkivat”. Informacioni i regjistrimit video mbrohet sipas ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Neni 20

Vula e KQV-së dhe Vula e Kryetarit të KQV-së

1. KQV-ja gjatë kohës së funksionimit përdor vulën e dërguar nga KQZ-ja dhe dorëzuar nga KZAZ-ja.
2. Vula e KQV-së përdoret nga sekretari, i cili e administron atë në përputhje me Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ-së dhe VKM nr. 390, datë 6.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”.
3. Vula e KQV-së vendoset në të gjitha vendimet e miratuara nga KQV-ja, dhe procesverbalet për administrimin e zgjedhjeve në QV.
4. Vula e Kryetarit të KQV-së përdoret vetëm për vulosjen e fletëve të votimit.
5. Vula e KQV-së dhe Vula e Kryetarit të KQV-së nuk mund të nxirren për asnjë arsye jashtë mjedisit të Qendrës së Votimit.
6. Në rast të dëmtimit apo nxjerrjes jashtë QV-së të vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së, zbatohen procedurat e përcaktuara me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, i ndryshuar.

PJESA II

VOTIMI

KREU I

ORARI DHE QENDRA E VOTIMIT

Neni 21

Orari i Votimit

1. Kur data e zgjedhjeve caktohet në periudhën zgjedhore nga 15 prilli deri më 15 maj, qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00.
2. Kur data e zgjedhjeve caktohet në periudhën zgjedhore nga 15 tetori deri më 15 nëntor, qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 18:00.
3. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes, sipas procedurave të parashikuara në nenin 39 të këtij Vendimi.

Neni 22

Mjedisi i Qendrës së Votimit

1. Në QV, në vend të dukshëm vendoset flamuri kombëtar.

2. Në hyrje të QV-së, vendoset tabela treguese e cila përmban numrin e Zonës së Administrimit Zgjedhor, numrin e QV-së, dhe orarin e votimit.
3. Kamera në mjediset e brendshme të QV-së vendoset në pozicion të tillë që të regjistrojë veprimtarinë e KQV-së, zgjedhësve dhe gjithë personave të tjerë të pranishëm në QV dhe në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk duhet të cënojë kryerjen në fshehtësi të votimit. Në hyrje të QV-së vendoset tabela qëparalajmëron ambienti vëzhgohet nga kamera.
4. Materialet informuese dhe edukuese për procesin e votimit të dërguara nga KQZ, afishohen nga KQV në një vend të dukshëm për zgjedhësit.

Neni 23

Personat e pranishëm në qendrën e votimit

1. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
 - a) anëtarët dhe sekretari i KQV-së;
 - b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
 - c) vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj;
 - ç) operatori teknik i QV-së i emëruar nga KQZ/ personi i ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerës në QV.
 - d) personeli teknik i njoftuar për dhënien e asistencës teknike në rastin kur PEI ose kamera ka probleme të funksionimit;
2. Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit. Përfshihen nga ky rregull punonjësit e Policisë së Shtetit, kur janë në ushtrim të detyrës, sipas parashikimit në nenin 37 të këtij Vendimi.

Neni 24

Dokumenti i identifikimit

1. Gjatë ushtrimit të detyrës anëtarët dhe sekretari i KQV-së, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit të funksionit që ata kanë.
2. Vëzhguesit e akredituar në KQV, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit të lëshuar sipas rastit nga KQZ ose KZAZ, dhe të kenë kartën e identitetit.
3. Operatori teknik i QV/ personi i ngarkuar me detyrën e vënies në funksionim të kamerës në QV, personeli teknik që ofron asistencë teknike për PEI/e kamerën, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit të funksionit që kanë, të lëshuar nga KQZ, dhe të kenë kartën e identitetit/ pasaportën.

KREU II PROCEDURAT PËR HAPJEN E VOTIMIT

Neni 25 **Veprime paraprake të KQV-së**

1. KQV-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve të subjekteve, një orë përpara hapjes së votimit:
 - a) vendos tryezat, karriget dhe dhomat e fshehta në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve, në përputhje me planvendosjen orientuese sipas skemës tip bashkëlidhur Udhëzimit nr.1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së endrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhje”.
 - b) sigurohet nga personi i caktuar me detyrë, që kamera është në funksion, dhe regjistron pa pengesa veprimet dhe kryerjen e procedurave nga anëtarët e KQV-së dhe zgjedhësi, dhe që nuk cënon fshehtësinë e votës së zgjedhësit;
 - c) heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 150 m;
 - ç) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
 - d) vendos materiale të tjera të kërkuara nga KQZ-ja;
 - dh) kontrollon të gjitha materialet e marra në dorëzim;
 - e) merr vendim për ndarjen e detyrave të anëtarëve të KQV-së.

Neni 26 **Aktivizimi i PEI**

(ndryshuar shkronja “d:”, e pikës 2, me vendimin nr. 12 date 24.3.2023)

1. Vënia në funksion e PEI, kryhet në qendrën e votimit, përpara hapjes së votimit, në prani të anëtarëve të KQV-së dhe të vëzhguesve të subjekteve, nga operatori teknik i QV-së, i caktuar nga KQZ.
2. Operatori teknik i QV-së:
 - a) pasi lidh PEI me rrjetin elektrik, kryen në radhë veprimet si më poshtë:
 - i. shtyp në ekranin e pajisjes kodin e konfigurimit;
 - ii. shtyp në ekranin e pajisjes numrin e qendrës së votimit;

- b) pas veprimeve sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi, në ekranin e PEI shfaqen numri i QV, vendodhja e QV-së dhe numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve të QV-së;
 - c) anëtarët e KQV-së verifikojnë informacionin që shfaqet në ekranin e PEI sipas shkronjës “b” të këtij paragrafi;
 - ç) kur të dhënat që shfaqen në ekranin e PEI janë të njëjta me të dhënat e QV-së, KQV autorizon operatorin teknik të vijojë konfigurimin e PEI për QV-në, duke shtypur butonin “konfirmo”;
 - d) *operatori teknik i QV-së identifikohet si përdorues i PEI – t, duke shtypur në ekranin e PEI – t kodin e operatorit.*
3. Pas kryerjes së procedurave sipas paragrafit 2 të këtij neni, PEI është e gatshme të kryejë verifikimin dhe identifikimin elektronik të zgjedhësve të QV-së, dhe printon menjëherë raportin e hapjes me të dhënat:
- a) llojin dhe datën e zgjedhjeve;
 - b) qarkun dhe bashkinë;
 - c) numrin e zonës së administrimit zgjedhor;
 - d) numrin e QV-së;
 - e) numrin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve të QV-së;
 - f) numrin e zgjedhësve që janë verifikuar nga PEI deri në atë moment, i cili duhet të jetë 0 (zero);
 - g) orën e printimit të raportit;
 - gj) numrin serial të PEI-t.
4. Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik dhe Libri i Protokollit të KQV-së nënshkruhen nga anëtarët e KQV-së, vulosen nga Sekretari i KQV-së me vulën e KQV-së.

Neni 27

Vulosja e kutive të votimit

(ndryshuar pika 2, me vendimin nr. 12 date 24.3.2023)

1. KQV-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve të subjekteve, një orë përpara hapjes së votimit, pasi u tregon vëzhguesve kutinë/të e votimit të zbrazëta, i mbyll ato, sipas procedurës:
 - a) vulos kutinë/të e votimit me kodet e sigurisë dhe numrat e vulave të sigurisë i shënon në Procesverbalin e Vulosjes së kutive të votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KQV-së.
 - b) Në rast se ndonjë nga vulat me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një nga vulat shtesë. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së

dhe në Procesverbalin e Vulosjes shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar dhe numri i kodit të sigurisë së vulës shtesë.

2. Sekretari i KQV-së mbyll origjinalin e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit në zarfin ku është shkruar “Zarf i Procesverbalit të Vulosjes”, dhe e fut atë në kutinë e votimit para fillimit të procesit të votimit. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, procesverbali i vulosjes së kutisë së votimit hartohet në 3 kopje, ku njëra është origjinale dhe 2 janë kopje të saj. Sekretari i KQV-së mbyll origjinalin e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit në zarfin ku është shkruar “Zarf i Procesverbalit të Vulosjes”, dhe e fut atë në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë. Kopjet e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit mbyllen respektivisht në 2 zarfet ku në secilin është shënuar “Zarf i Procesverbalit të vulosjes”, dhe një zarf futet në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë dhe tjetri në kutinë e materialeve të votimit. Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik, sipas pikës 3, të nenit 26 të këtij vendimi, futet në kutinë e materialeve të votimit.
3. Kopje e Procesverbalit të Vulosjes, dhe raportit të hapjes së procesit të identifikimit elektronik, të vulosur me vulën e KQV-së, u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.

Neni 28 Hapja e votimit

1. Pas kryerjes të procedurave sipas nenit 26 dhe 27 të këtij vendimi, KQV merr vendim për hapjen e votimit. Kryetari i KQV-së deklaron hapjen e votimit jo më përpara orës së parashikuar në nenin 21 të këtij Vendimi.
2. Sekretari i KQV-së shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari të KQV-së që largohet prej qendrës së votimit.
3. Kur kryetari largohet nga qendra e votimit, i kalon, anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike, deri në çastin e rikthimit të tij, vulën e kryetarit të KQV-së, listën e zgjedhësve si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar atij. Sekretari i KQV-së bën shënimin përkatës në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.
4. Kur sekretari largohet nga qendra e votimit, i kalon anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike, deri në çastin e rikthimit të tij, vulën e KQV-së, Librin e Protokollit të Mbledhjeve si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar atij . Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së bëhet shënimi përkatës për pasqyrimin e këtij fakti.

KREU III
PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

Neni 29

Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit

1. Pas hyrjes së zgjedhësit në qendrën e votimit:
 - a) zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të lefishme të identitetit me të dhëna biometrike, si më poshtë:
 - i. letërnjoftim (kartë identiteti);
 - ii. ose pasaportë;
2. Kryetari i KQV-së, pasi verifikon se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, i dorëzon dokumentin e identitetit të zgjedhësit operatorit teknik të QV-së.
3. Zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga një anëtar i caktuar me vendim të KQV-së me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

“Neni 30

Identifikimi elektronik i zgjedhësit
(ndryshuar me vendimin nr. 12 date 24.3.2023)

1. Operatori teknik i QV-së:

- a) skanon me rrëshqitje letërnjoftimin ose pasaportën e zgjedhësit në hapësirën e lexuesit MRZ të PEI. Nëse zgjedhësi është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së, dhe nuk është identifikuar më parë, në ekran shfaqen emri, mbiemri, numri personal, fotografia dhe numri rendor i zgjedhësit në listën e zgjedhësve. PEI përmes ngjyrës jeshile në ekran, vërteton se të dhënat e identitetit të zgjedhësit u lexuan me sukses;
- b) orienton zgjedhësin të depozitojë në skanuesin e gjurmëve të gishtërinjve të PEI-t:
 - i. gjurmën e gishtit të madh të dorës së djathtë,
 - ii. të riprovtojë depozitimin e gjurmës së gishtit të madh të dorës së djathtë deri në 3 herë, kur në depozitimin e parë gjurma nuk u lexua nga PEI,
 - iii. kur pas kryerjes së veprimeve sipas nënpika “i” dhe “ii”, PEI nuk konfirmon depozitimin e gjurmës së gishtit të madh të dorës së djathtë të zgjedhësit, operatori teknik, i kërkon zgjedhësit të depozitojë gjurmën e gishtërinjve të tjerë sipas orientimeve që shfaqen në ekranin e PEI.

c) i dorëzon Kryetarit të KQV-së, dokumentin fizik të printuar nga PEI, për kryerjen e identifikimit elektronik të zgjedhësit i cili përmban:

i. numrin e QV-së,

ii. datën dhe orën e kryerjes së verifikimit,

iii. emrin, mbiemrin, numrin personal dhe fotografinë e zgjedhësit,

iv. numrin e zgjedhësit në listën e zgjedhësit të QV-së.

ç) Kryetari i KQV-së, administron dokumentin fizik të dorëzuar nga operatori në zarfën ku është shënuar “Vërtetime të Identifikimit Elektronik të Zgjedhësve”;

d) Zgjedhësit i jepet fleta e votimit, pasi ai ka kryer identifikimin elektronik;

dh) Përpara se zgjedhësit t’i jepet fleta e votimit ajo vulozet në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e kryetarit të KQV-së.

2. Në rastet kur për shkak të dëmtimeve fizike, dokumenti i identitetit të zgjedhësit nuk lexohet nga PEI, operatori teknik i QV-së shtyp në mënyrë manuale të dhënat e zgjedhësit në ekranin e PEI.

3. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të kryejë identifikimin elektronik, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Neni 31

Raste të veçanta të identifikimit elektronik të zgjedhësit

(ndryshuar me vendimin nr. 12 date 24.3.2023)

1. KQV, lejon operatorin teknik të QV-së të vijojë me identifikimin e zgjedhësve që paraqiten në qendrën e votimit në rastet e mëposhtme:

a) zgjedhësi i cili nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit dhe paraqitet për të votuar me vendim gjykate i cili i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi,

b) anëtarët e KQV-së, anëtari i KZAZ i pajisur me vendim të KZAZ-së për të votuar në atë QV, të cilët nuk janë të regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së,

c) operatori teknik i QV-së/personi i ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerës, nëse nuk është zgjedhës në atë qendër votimit dhe është zgjedhës i zonës zgjedhore.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, operatori teknik i QV-së:

a) shtyp në ekranin e PEI butonin “rast i veçantë”,

b) skanon dokumentin e identifikimit të zgjedhësit në hapësirën e MRZ,

c) Pas leximit të të dhënave të zgjedhësit nga PEI, zgjedhësi depoziton gjurmën e gishtit në skanuesin e gjurmëve të gishtërinjve të PEI.

3. Kur përpara KQV-së paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së, por është i pajisur me vendim gjykate, i cili i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi,

KQV-ja shënon emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit, numrin e dokumentit të identifikimit në një regjistër të posaçëm, të cilit i bashkëlidh vendimin e gjykatës. Pas regjistrimit të të dhënave të zgjedhësit të pajisur me vendim gjykate në regjistrin e posaçëm, KQV lejon operatorin teknik të QV-së të kryejë identifikimin elektronik të zgjedhësit.

4. Në rastet kur pavarësisht ndjekjes së procedurave të përcaktuara në nenin 30, pika 1, shkronja “b” të këtij vendimi, është e pamundur të depozitohen gjurmët e gishtërinjve, ndiqet kjo radhë veprimesh:

a) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve,

b) pajisja PEI printon dokumentin fizik që evidenton zgjedhësin e identifikuar pa shenja gishtërinjsh, dokument në të cilin zgjedhësi shënon emrin, mbiemrin dhe firmën,

c) zgjedhësit i dorëzohet fleta e votimit,

ç) zgjedhësit nuk i dorëzohet fleta e votimit vetëm në rast se nuk ka nënshkruar në listën e zgjedhësve, sipas shkronjës “a” të kësaj pike.

d) sekretari i QV-së i pasqyron këto fakte në Librin e protokollit të Mbledhjeve duke shënuar orën, identitetin e zgjedhësit me shënimin “Zgjedhësi u identifikua me nënshkrim pa shenjë gishtërinjsh”, si dhe rastet e mosnënshkrimit të dokumentit të printuar nga PEI. Evidentimi i fakteve në librin e Protokollit të Mbledhjeve nënshkruhet nga sekretari i QV-së dhe operatori.

5. Sekretari i KQV-së mban shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së rastet kur KQV ka lejuar identifikimin elektronik të zgjedhësit sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 32

Zgjedhësi që tenton të votojë për herë të dytë (ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 15 date 12.4.2021)

1. Në rastin kur zgjedhësi që ka votuar më parë në atë QV duke u identifikuar përmes PEI-t, tenton të kryejë sërish identifikimin elektronik:

a) KQV sinjalizohet përmes një tingulli të posaçëm dhe ngjyrës së kuqe që shfaqet në ekranin e PEI;

b) PEI printon menjëherë vërtetimin me emrin, mbiemrin, numrin personal, datën e lindjes, dhe fotografinë e personit, orën kur ky person ka votuar në QV, me tekstin “tentativë për votim të dyfishtë” ;

2. Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Kryetari pasi verifikon informacionin me dokumentin e printuar nga PEI, dhënë nga Operatori teknik/personi i autorizuar nga KQZ, e administron atë dhe e fut në zarfin ku shënohet “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”.

Neni 33

Zgjedhësi që paraqitet në QV ku nuk është i regjistruar

1. Në rastin kur zgjedhësi nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së:
 - a) KQV sinjalizohet përmes një tingulli dhe ngjyrës së verdhë që shfaqet në ekranin e PEI;
 - b) në ekran shfaqet numri i QV ku zgjedhësi është i regjistruar;
 - c) printohet dokumenti me datën, orën, dhe numrin e QV-së ku zgjedhësi është i regjistruar, i cili i dorëzohet zgjedhësit për orientim.
2. Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Neni 34

Votimi

1. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon me shenjën “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij, vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij.
2. Zgjedhësi, pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletën e votimit, në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, por të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës të jetë e dukshme. Zgjedhësi, pasi del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën e votimit në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.
3. Zgjedhësi voton vetëm për vete, me përjashtim të rastit të përcaktuar në nenin 36 të këtij Vendimi.
4. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së, operatori teknik i QV-së/personi i ngarkuar për funksionimin e kamerës, votojnë pasi kanë votuar të gjithë zgjedhësit e pranishëm në qendrën e votimit brenda orarit të mbylljes së votimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen.

Neni 35

Fletët e votimit të dëmtuara

1. Nëse shënimi në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të futë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i KQV-së merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët “E DËMTUAR” dhe e fut atë në zarfin “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”. Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletë votimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA” dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

2. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA” dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi e dytë. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA” dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.
3. Në qendrën e votimit nuk lejohet përdorimi i telefonisë celulare nga ana e zgjedhësit dhe zgjedhësi nuk lejohet të votojë duke mbajtur aparatin telefonik në dorë. Nëse zgjedhësi tenton të përdorë aparatin telefonik apo çdo pajisje tjetër regjistrimi në dhomën e fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të futë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i KQV-së merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët “E DËMTUAR” dhe e fut atë në zarfin “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”. Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletë votimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA” dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.
4. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.

Neni 36

Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë

1. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj QV-je. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.
2. Kryetari i KQV-së verifikon se personi që do të ndihmojë zgjedhësin që nuk mund të votojë vetë, është në listën e zgjedhësve të asaj QV-je. Verifikimi kryhet në listën e zgjedhësve të QV-së.
3. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
4. Pasi zgjedhësi që kërkon ndihmë për të votuar ka kryer identifikimin elektronik, personi që do ta ndihmojë, para se të shënojë në fletën e votimit, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.
5. Pas kryerjes së procedurave sipas paragrafit 4 të këtij neni, zgjedhësi i shoqëruar nga personi që do ta ndihmojë hyn në dhomën e fshehtë. Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.

6. Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

Neni 37

Rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit

1. Kur në QV rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja njofton organet e Policisë së Shtetit dhe KZAZ-në, si dhe plotëson proceverbalin e pezullimit të votimit për këtë qëllim. Në procesverbal shënohet ora e njoftimit dhe pezullimit të votimit. KQV-ja shënon, gjithashtu, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve incidentin e ndodhur, orën e ndërprerjes së votimit dhe orën e rifillimit të tij.
2. Kryetari ose çdo anëtar i KQV-së njofton menjëherë KZAZ-në për incidentin e ndodhur. KZAZ-ja është e detyruar të shënojë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së njoftimin dhe orën e marrjes së tij. KZAZ-ja ia përcjell kërkesën menjëherë organeve të Policisë së Shtetit.
3. Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja u kërkon organeve të Policisë së Shtetit të largohen nga QV dhe merr masa për rifillimin e menjëhershëm të votimit. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e rifillimit të votimit.
4. Në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave, përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar, vëzhguesve, përfaqësuesve të medias së autorizuar, si dhe e personave të ngarkuar me kryerjen e sondazheve për votimin, kur organizata që ata përfaqësojnë është autorizuar për këtë qëllim nga KQZ-ja.
5. Prezenca e personave të tjerë, jashtë parashikimeve të paragrafit 4 të këtij neni, në rrethinat e QV në një rreze prej 150 m, është shkak për pezullimin e procesit dhe për të kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin.

Neni 38

Informacioni për zhvillimin e votimit

(shtuar pika 6 me vendimin nr. 12 date 24.3.2023)

1. KQV, ditën e votimit, jep informacion pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për:
 - a) orën e hapjes së votimit, dhe arsyen e vonesës në rast të hapjes së votimit tej orës së përcaktuar në nenin 21 të këtij vendimi;
 - b) pas orës 7:00 të hapjes së votimit, në orare sipas parashikimeve të paragrafit 4 të këtij neni, për numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në QV deri në atë orë, dhe

- përkatësinë gjinore të tyre;
- c) orën e ndërprerjes së votimit, në se ndodh, arsyen si dhe orën e rifillimit të votimit;
- ç) orën e saktë të mbylljes së votimit, numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar dhe përkatësinë gjinore të tyre.
2. Sekretari i KQV-së është përgjegjës për dhënien e informacionit në KQZ sipas paragrafit 1 të këtij neni.
 3. KQZ, administron në bazën e të dhënave informacionin e marrë nga sekretarët e KQV sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe e publikon atë në dinamikë deri në përfundim të votimit, në sallën e mediave dhe në faqen e KQZ-së në internet.
 4. Oraret e dhënies së informacionit dhe forma e publikimit për pjesëmarrjen në votim, si dhe mënyra e transmetimit të informacioneve të përmendura në këtë nen, në KQZ, përcaktohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
 5. Anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe operatorët teknikë, për raportimin/informimin e aspekteve procedurale që lidhen me zbatimin e proceseve të punës të përcaktuara në këtë vendim, përdorin paralelisht edhe mjetet dhe platformat e ndërveprimit elektronik, sipas udhëzimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 6. *Në rast se transmetimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, realizohet drejtpërdrejtë nga PEI në KQZ, lloji i të dhënave të transmetuara dhe mënyra e transmetimit do të bëhet në përputhje me vendimin nr. 7, datë 20.2.2023, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre.*

KREU IV MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Neni 39 **Mbyllja e votimit**

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën e caktuar, në përputhje me nenin 21 të këtij vendimi.
2. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, KQV-ja mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.

3. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, votojnë anëtarët e KQV-së dhe operatori teknik i QV-së/personi i ngarkuar për funksionimin e kamerës.
4. KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin tip përkatës, duke shënuar në të edhe orën e mbylljes së votimit. Vendimi për mbylljen e votimit dhe ora e saktë e mbylljes së tij shënohen edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.
5. Operatori teknik i QV-së zbaton vendimin e KQV-së dhe mbyll procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve duke përdorur kartën SMART dhe kodin Autorizues. Pas kësaj, PEI nuk kryen më identifikim elektronik të zgjedhësve.

Neni 40

Raporti i mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve

1. Menjëherë pasi operatori teknik i QV-së ka mbyllur procesin e identifikimit të zgjedhësve në QV, sipas paragrafit 5 të nenit 39 të këtij vendimi, PEI printon raportin e mbylljes i cili përmban:
 - a) Qarkun;
 - b) Bashkinë;
 - c) numrin e zonës së administrimit zgjedhor;
 - ç) numrin e qendrës së votimit;
 - d) orën e printimit të raportit;
 - dh) numrin serial të pajisjes PEI;
 - e) numrin e zgjedhësve në listën e QV-së;
 - ë) numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht, duke specifikuar:
 - i.numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht të ndarë sipas gjinisë;
 - ii.numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht pa gjurmë të gishtërinjve
 - iii.numrin e rasteve të veçanta të identifikimit të zgjedhësve (zgjedhës me vendim gjykatë, administratë zgjedhore);
 - f) numrin e tentativave për votim të dyfishtë;
 - g) numrat rendorë të zgjedhësve të identifikuar elektronikisht në listën e zgjedhësve.
 - gj) numrin e zgjedhësve që nuk janë paraqitur për votim.
2. Raporti i mbylljes sipas paragrafit 1 të këtij neni, nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së, dhe vulloset nga Sekretari me vulën e KQV-së, dhe administrohet nga Kryetari i KQV-së.
3. Operatori teknik i QV-së fik PEI-n, dhe e vendos atë në valixhe. KQV mbyll valixhen me vulë me kodsigurie, i cili shënohet në procesverbalin e dorëzimit të PEI dhe në Librin e

Protokollit të Mbledhjeve. Procesverbali i mbylljes së PEI nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së, dhe një kopje e tij mbyllet në kutinë e materialeve të votimit.

4. Në rast se vula me kodsigurie dëmtohet gjatë gjatë mbylljes së valixhes së PEI-t, ajo zëvendësohet me një nga vulat shtesë. Në Procesverbalin për dorëzimin të PEI dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar. Nëse ndonjë nga anëtarët e KQV-së ka vërejtje, ato shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
5. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe/ose të huaj dhe përfaqësuesit e akredituar të medias.

Neni 41

Veprimet pas mbylljes së identifikimit elektronik
(ndryshuar pika 6 me vendimin nr. 12 date 24.3.2023)

Kryetari së bashku me anëtarët e KQV-së, pas mbylljes së PEI në valixhe sipas parashikimeve të paragrafit 4 të nenit 40 të këtij vendimi, kryejnë, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:

1. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së:
 - a) i deklaron me zë të lartë anëtarëve të tjerë të KQV-së dhe vëzhguesve të pranishëm numrin e zgjedhësve që kanë votuar, sipas numrit të zgjedhësve të identifikuar elektronikisht në raportin e mbylljes të printuar nga PEI, dhe numrin e zgjedhësve femra të identifikuar;
 - c) i fton ata të verifikojnë shifrën e thënë prej tij; dhe
 - ç) urdhëron sekretarin e KQV-së të shënojë në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së numrin e personave që kanë votuar në qendrën e votimit, sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal. Sekretari i KQV-së shënon pretendimin në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, pasqyron në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, numrin e fletëve të votimit të qendrës së votimit, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KZAZ-ja.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të KQV-së. Nëse

kërkohej nga një anëtar i KQV-së ose ndonjë nga vëzhguesit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura. Në përfundim të numërimit, fletët e votimit të papërdorura mbylljen në zarfin ku është shënuar “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA”. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse ndonjë nga vëzhguesit ka vërejtje, ato shënohen menjëherë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve ose paraqiten nga vëzhguesit me shkrim. Vërejtjet me shkrim administrohen nga sekretari dhe mbylljen në kutinë e materialeve të votimit së bashku me dokumentacionin tjetër të qendrës së votimit.
5. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mbylljen në kutinë e materialeve zgjedhore:
 - a) zarfi ku janë vendosur fletët e votimit të papërdorura;
 - b) zarfi ku janë vendosur “FLETË VOTIMI TË DËMTUARA”;
 - c) zarfi “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”;
 - ç) lista e zgjedhësve, përfshirë edhe regjistrin e posaçëm të zgjedhësve;
 - d) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;
 - dh) vula e KQV-së;
 - e) vula e kryetarit të KQV-së;
 - ë) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;
 - f) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara;
 - g) procesverbali i mbylljes së PEI;
 - gj) Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.
6. *Numrat e kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia/itë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, shënohen paraprakisht në “Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KQV-së. Pasi hidhen të gjitha të dhënat në “Procesverbalin për Mbylljen e Votimit”, shënohet ora e saktë e mbylljes së votimit. Origjinali i “Procesverbalit për Mbylljen e Votimit” futet në kutinë e votimit, e cila vulolet menjëherë me kodin e pestë të sigurisë, ndërsa kopje të tij futen në kutinë e materialeve të votimit, e cila më pas vulolet me kodet përkatëse të sigurisë. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore origjinali i “Procesverbalit për Mbylljen e Votimit” futet në kutinë e votimit për kryetar bashkie. Kopje të*

procesverbalit të mbylljes së votimit futen përkatësisht në kutinë votimit për këshillin e bashkisë dhe në kutinë e materialeve të votimit. Raporti i mbylljes, i printuar automatikisht nga PEI sipas përcaktimeve të nenit 40 të këtij vendimi, futet në kutinë e materialeve të votimit. Kopje të Procesverbalit për Mbylljen e Votimit dhe të raportit të mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve të riprintuar pa përfshirë numrin rendor në listë të zgjedhësve, u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.

7. Në rast se gjatë mbylljes së kutisë së votimit vula me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një nga vulat shtesë. Në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar.
8. Procesverbali i Mbylljes së Votimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Nëse ndonjë nga anëtarët e KQV-së ka vërejtje, ato shënohen në hapësirën e posaçme për vërejtjet në procesverbal.
9. Menjëherë pas përfundimit të veprimeve sipas këtij neni, kutia e votimit me fletët e votimit, kutia e materialeve të votimit dhe PEI dërgohen në Vendin e Numërimit të Votave sa më shpejt të jetë e mundur. Dërgimi i tyre në VNV bëhet me automjet në të cilin ndodhet edhe një punonjës i policisë që ka detyrë të garantojë shoqërimin dhe mosprekjen e tyre.

KREU V FUNKSIONIMI I PEI

Neni 42 **Veprime të KQV-së kur PEI nuk funksionon**

1. Në rastet kur PEI shfaq probleme të funksionimit, operatori teknik i QV-së i prezanton problemin anëtarëve të KQV-së dhe menjëherë njofton qendrën e asistencës teknike.
2. KQV merr vendim për pezullimin e votimit dhe njofton menjëherë KZAZ-në për orën dhe shkakun e pezullimit të votimit.
3. Në vendim dhe në librin e Protokollit të KQV-së, shënohet ora e pezullimit të votimit, ora e njoftimit të qendrës së asistencës teknike, si dhe një përshkrimi i shkurtër i problemit të shfaqur nga PEI. Rifillimi i procesit të identifikimit elektronik të zgjedhësve, pas riparimit PEI apo zëvendësimit të saj, kryhet jo më vonë se tre orë nga koha e njoftimit të problemit në qendrën e asistencës teknike.

Neni 43 **Zëvendësimi i PEI**

1. Kur personeli i qendrës së asistencës teknike vlerëson nevojën për të zëvendësuar PEI:
 - a) procesi i zëvendësimit kryhet në mjediset e QV-së, në prani të anëtarëve të KQV-së, operatorit teknik dhe të vëzhguesve:
 - b) sekretari i KQV-së regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve:
 - i. orën e zëvendësimit të PEI;
 - ii. numrin e pajisjes që zëvendësohet dhe numrin e pajisjes që do të vihet në punë;
 - iii. numrin e vulave me kode sigurie me të cilat është mbyllur valixhja e pajisjes që do të vihet në punë;
 - iv. numrin e vulës me kod sigurie që këputet për të nxjerrë memorjen e jashtme (USB) nga PEI që zëvendësohet;
 - v. numrin e vulës me kod sigurie me të cilën mbyllet hapësira e PEI ku vendoset memorja e jashtme (USB) e nxjerrë nga PEI që është jashtë funksionit;
 - vi. numrin e kodit të vulës së sigurisë me të cilën është mbyllur porta hyrëse e PEI që vihet në punë, brenda së cilës është hapësira për lidhjen e pajisjes me rrjetin elektrik.
 - c) operatori teknik i QV-së vijon identifikimin elektronik të zgjedhësve përmes PEI-t që u vu në punë.
2. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet ora e rifillimit të votimit.

Neni 44

Zhvillimi i votimit në rastet e mosfunksionimit të PEI

1. Në rast se PEI nuk është riparuar apo nuk është zëvendësuar, pas kalimit të tre orëve nga koha e njoftimit të qendrës së asistencës teknike, KQV merr vendim për të vijuar votimin duke zbatuar procedurat për identifikimin e zgjedhësit si më poshtë:
 - a) Pas hyrjes së zgjedhësit në qendrën e votimit, zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike, si më poshtë:
 - i) letërnjoftim (kartë identiteti);
 - ii) ose pasaportë;
 - b) një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së, kontrollon zgjedhësit në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së dhe para marrjes së fletës së votimit, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme. Në rast se zgjedhësi është timbruar, anëtari i KQV-së ia bën të ditur menjëherë këtë fakt anëtarëve të tjerë të KQV-së, të cilët e verifikojnë

- menjëherë. Emri dhe mbiemri i këtij zgjedhësi shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe atij nuk i jepet fletë votimi;
- c) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
 - ç) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
 - d) fleta e votimit vulozet në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e kryetarit të KQV-së;
 - dh) zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga një anëtar i caktuar me vendim të KQV-së me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.
 - e) Votimi kryhet sipas parashikimeve të nenit 34 të këtij Vendimi.
2. Vendimi i KQV-së për zhvillimin e votimit pa kryerjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve, ora e tij, shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, dhe i njoftohen menjëherë KQZ-së dhe KZAZ-së. Kopje të vendimit, të vulosura me vulën e KQV-së i jepen vëzhguesve të partive parlamentare.
3. Mbyllja dhe dorëzimi i PEI kryhet sipas parashikimeve të paragrafit 4 të nenit 39 të këtij Vendimi.

Neni 45

Veprimet pas mbylljes së votimit në rastin e mosfunksionimit të PEI

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit të zhvilluar pjesërisht apo plotësisht pa identifikimin elektronik të zgjedhësve, kryetari së bashku me anëtarët e KQV-së kryejnë, sipas radhës, veprimet sipas parashikimeve të nenit 41 të këtij Vendimi.
2. Shënojnë në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së numrin e zgjedhësve dhe numrin e femrave që kanë votuar, bazuar në:
 - a) numrin e zgjedhësve që janë identifikuar elektronikisht, sipas raportit të printuar nga PEI;

- b) nënshkrimet e zgjedhësve në listën e zgjedhësve dhe në regjistrin e posaçëm sipas nenit 57 të Kodit Zgjedhor.
3. Në rastin kur PEI nuk ka printuar raport me të dhëna për numrin e zgjedhësve të identifikuar pas ndërprerjes së funksionimit, Kryetari i KQV-së, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së:
- a) shënon numrin e zgjedhësve që janë identifikuar nga PEI sipas numrit të dokumenteve fizikë të administruara në zarfën “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”;
- b) ia deklaron shifrën me zë të lartë anëtarëve të tjerë të KQV-së dhe vëzhguesve të pranishëm;
- c) i fton ata të verifikojnë shifrën e thënë prej tij; dhe
- ç) urdhëron sekretarin e KQV-së të shënojë në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së numrin e personave që kanë votuar në qendrën e votimit, duke u identifikuar sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në proceverbal. Sekretari i KQV-së shënon pretendimin në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

KREU VI

PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET

Neni 46

Përgjegjësia e anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit

Anëtarët dhe sekretari i KQV-së mbajnë përgjegjësi penale ose administrative sipas legjislacionit në fuqi për shkeljen e dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Anëtarët e KQV-së, që kanë lejuar një zgjedhës të votojë më shumë se një herë ose në emër të zgjedhësve të tjerë, mbajnë përgjegjësi penale, në përputhje me nenin 324/a i Kodit Penal, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 36 të këtij Vendimi.

Neni 47

Sanksione administrative

1. Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, kur nuk përbën veprë penale dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë.
2. Shkelja e rregullave të nenit 41 të Kodit Zgjedhor nga ana e sekretarit të KQV-së dënohet me gjobë nga 30,000 deri në 60,000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj.

3. Gjoha vendoset nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e financës në KQZ.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

Neni 48
Formimi kalimtar i KQV-ve

Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, e drejta për propozimin e anëtarëve të KQV-ve, përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.

Neni 49
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Udhëzimi Nr.2, datë 4.03.2015, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Qendrës së Votimit”.

Neni 50
Hyrja në fuqi dhe ankimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilirjana NANO - Kryetare

Arens ÇELA - Anëtar

Dritan ÇAKA - Anëtar

Helga VUKAJ - Anëtare

Muharrem ÇAKAJ - Anëtar



logo e partisë

Lista e kandidatave të Partisë _____ për KQV-të e ZAZ-së _____

Nr.	nr. KQV	Funksioni	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindja	Nr.personal ID	Arsimi	Gjinia	Nr.tel	e-mail

emër, mbiemër, firmë

Vula e partisë

DEKLARATË

Unë _____, i biri/e bija e _____ dhe i/e _____, i datëlindjes _____._____._____, me nr. personal të identitetit _____, i propozuar nga Partia _____ për emërim në përbërje të KQV _____, Bashkia _____, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

1. nuk jam i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
2. nuk kam marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
3. nuk jam në marrëdhënie pune me ndonjë nga kandidatët që konkurojnë në zonë;
4. kam arsimin e mesëm/të lartë _____; (plotëso për nivelin më të lartë të arsimit të kryer)
5. nuk jam deputet ose kandidat për deputet në Kuvend;
6. nuk jam kandidat ose i zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
7. nuk jam ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
8. nuk jam anëtar apo sekretar i një komisioni tjetër zgjedhor.
9. nuk ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore

Përmes kësaj deklarate, gjithashtu jap pëlqimin që të mblidhen, përpunohen dhe administrohen të dhënat e mia personale nga KZAZ/KQZ. Deklarata lëshohet me vullnet të lirë dhe të plotë, duke pasur parasysh parashikimet e nenit 6 paragrafi 1, dhe nenit 7, pikat 1, të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Lëshuar më _____._____._____

DEKLARUESI

(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Rregullat e përdorimit dhe specifikimet teknike të kamerave regjistruese në Qendrat e Votimit*(ndryshuar titulli me vendimin nr. 6 date 27.01.2022)*

- 1) Për çdo problematike ose mos funksionalitet të kamerave në Qendrat e Votimit, Operatori kontraktor duhet të zgjidhë problematikën ose ndërrimin e kamerës brenda 2 orëve nga momenti i njoftimit.
- 2) Operatori kontraktor duhet të sigurojë punonjësit e nevojshëm për të pranuar thirrje telefonike në rast problematikash me kamerat e regjistrimit në Qendrat e Votimit.
- 3) Operatori kontraktor duhet të sigurojë ruajtjen dhe dorëzimin në KQZ të pamjeve filmike (video) pas mbarimit të procesit të votimit për një kohë jo më të vonë se 1 muaj ose para këtij afati për kërkesa mbi këqyrjen që bëhet në kuadër të procesit ankimor.
- 4) Çdo kamerë regjistrimi e QV-ve do të dorëzohet tek KZAZ-ja përkatëse. Dorëzimi i kamerave do të ruhet në proces-verbal.
- 5) Procesi i regjistrimit dhe transmetimit në të gjitha kamerat e QV-ve duhet të ketë pavarësi nga energjia elektrike për të paktën 120 minuta.
- 6) Kamerat duhet të jenë me mbrojtje “anti-vandal” si dhe të mbyllura në mënyrë të tillë që të mos lejojë nxjerrjen e informacionit video të regjistruar në QV, përveç punonjësve të specializuar të operatorit kontraktor.
- 7) Parametrat teknik minimal të kamerave duhet të jenë me rezolucion të lartë, të paktën 1920x1080 pixel (Full High Definition, FHD) si dhe shpejtësia e regjistrimit video jo më e vogël se 25 frames për sekondë në rezolucionin e kërkuar.
- 8) Kapaciteti i ruajtjes së informacionit video në memorien e kamerave nuk duhet të jetë më i vogël se 128GB.
- 9) Të gjitha imazhet e mara nga kamerat duhet të regjistrohen në formë digjitale gjatë gjithë procesit të numërimit të votave, në format “mp4”, “avi” ose në çdo formë tjetër elektronike të lexueshme lehtësisht.